

VENDIM
Nr.1194, datë 29.8.2008

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË GJASHTË AUTOKOLONAVE DHE TRUPAVE USHTARAKE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë-Porti i Durrësit, në datat 30 gusht 2008 dhe 5 e 6 shtator 2008, dhe Porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datat 31 gusht 2008 dhe 8 shtator 2008, të 6 (gjashtë) autokolonave dhe trupave ushtarake italiane, të përbëra, përkatësisht:

- Autokolona e parë, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) automjete dhe 32 (tridhjetë e dy) trupa ushtarake.

- Autokolona e dytë, me 10 (dhjetë) automjete dhe 20 (njëzet) trupa ushtarake.

- Autokolona e tretë, me 6 (gjashtë) automjete dhe 57 (pesëdhjetë e shtatë) trupa ushtarake.

- Autokolona e katërt, me 12 (dymbëdhjetë) automjete dhe 40 (dyzet) trupa ushtarake.

- Autokolona e pestë, me 9 (nëntë) automjete, nga të cilat 1 (një) ushtarak dhe 8 (tetë) të tjerat civile, dhe 2 (dy) trupa ushtarakë e 9 (nëntë) civilë.

- Autokolona e gjashtë, me 13 (trembëdhjetë) automjete dhe 40 (dyzet) trupa ushtarake.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për dy autokolonat e para dhe trupat ushtarake italiane të jetë pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes të jetë pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit, në datën 30 gusht 2008.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën e tretë dhe të gjashtë dhe trupat ushtarake italiane të jetë pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit dhe pika e daljes të jetë pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë, përkatësisht, në datat 31 gusht 2008 dhe 8 shtator 2008.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën e katërt dhe të pestë dhe trupat ushtarake italiane të jetë pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë, dhe pika e daljes të jetë pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit, përkatësisht, në datat 5 e 6 shtator 2008.

2. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër , më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

3. Autokolonat dhe trupat ushtarake italiane, gjatë itinerarit të lëvizjes nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyjnë në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha